



Prishtinë: 01.03.2013

Kodi i ZRRE-së: V_508_2013

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_865_09_12

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_865_09_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 08.01.2013.

Në mbledhjen e mbajtur më 01 mars 2013 nxorri këtë:

VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin U.G (I.T) (shifra në KEK: DPR - 90047766), nga Besiana si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_865_09_12 i datës 26.09.2012.

Arsyetim

Me datë 06.05.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë bërë pranimin e instalimit elektrik për njehsori elektrik nr. 44665835. Pas kësaj punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me datë 30.06.2010 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë larguar nga matja njehsori elektrik nr. 44665835 dhe kanë vendosur për matje njehsori e vet elektrik nr. 3660526.

Me datë 04.09.2010 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsori elektrik nr. 44665835, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori qelqin e ka të thyer dhe kapakun e epërm, si dhe numëruesi i njehsori është i manipuluar.

Me datë 04.11.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me qëllim të regjistrimit të pajisjeve, por që kanë konstatuar se nuk kanë qasje por që konsumatori furnizohet me kabull të seksionit 4x16mm².

Me datë 11.08.2011 KEK-u ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR11HP10192 në vlerë prej 1,156.06 €.

Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK, me të cilën ka kundërshtuar faturën e rikthimit të humbjeve në vlerë prej 1,156.06 €. KEK me datë 29.09.2011 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin për pranimin e njehsori elektrik si dhe procesverbalin e kalibrimit.

Konsumatori me datë 11.10.2011 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke kundërshtuar përgjigjen e KEK-ut, DMK ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 26.09.2012 ka nxjerr vendim duke **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të shkarkoj konsumatorin në shifrën DPR – 90047766 nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR11HP10192 të datës 11.08.2011 në vlerë financiare prej 1,156.06€.



Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 08.01.2013 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore.

Baza e kundërshtimeve të KEK-ut të theksuara në ankesë është për faktin se DMK, gjatë vendosjes së kësaj lënde ka bërë gabimisht vlerësimin e provave dhe shkresave të lëndës pasi që sektori i kalibrimit e ka konstatuar se njehsori elektrik është keqpërdorur nga ana e konsumatorit dhe se bllobmat shtetërore janë të manipuluar, ndërsa numëruesi është i manipuluar ka gjurmë të kthimit prapa të numrave në numëror dhe mbi bazën e këtij konstatimi KEK, ka ngarkuar konsumatorin me faturë të rikthimit të humbjeve. KEK, në pikën 2 të ankesës ka theksuar se edhe nga rrjedha e energjisë elektrike shihet se kemi ndryshim të kilovatëve të shpenzuar para dhe pas vendosjes së njehsorit të ri gjë që dëshmon qartë se konsumatori ka keqpërdorur energjinë elektrike.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 01 mars 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara, gjithashtu vlerësimin se procesverbali i lëshuar nga sektori i kalibrimit është proces meritore me të cilën konstaton manipulimet e bëra në njehsor elektrik si dhe argument tjetër që vërteton keqpërdorimin e njehsorit nga konsumatori është edhe analiza e rrjedhës së energjisë elektrike që vërteton ndryshimin e shpenzimit të energjisë me njehsor të ri. Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të gjitha pikave të kundërshtimit konstaton se KEK, me rastin e atakimit të këtij vendimi nuk ka ofruar prova bindëse me të cilën e vërteton faktin se konsumatori i ka shkaktuar humbje nga ajo çka thirret KEK në procesverbalin e kalibrimit.

Bordi i ZRRE-së gjithashtu ka analizuar edhe gjithë rrjedhën e energjisë elektrike të shpenzuar nga ana e konsumatorit dhe në këtë rast ka konstatuar se ky konsumator nuk ka ndryshim në shpenzim të energjisë me njehsor të vjetër dhe njehsor të ri ashtu siç thekson KEK, në ankesën e tij, pasi që nga të dhënat që shihen në listat e leximit del se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor të vjetër dhe njehsor të ri është përafërsisht e njëjtë. Gjithashtu nga rrjedha e energjisë elektrike vërehet se njehsori elektrik nr. 44665835 nga periudha 05/2009 deri në periudhën 07/2010 nuk ka bërë fare regjistrimin e shpenzimit të energjisë elektrike në tarifën e parë, por vetëm në tarifën e dytë, që do të thotë se KEK, nuk ka vepruar konform Procedurës së leximit dhe faturimit të njehsorëve elektrik.

Sa i përket konstatimeve të bëra në ankesën e KEK, se procesverbali i kalibrimit është proces meritore, Bordi i ZRRE-së, konstaton se sipas nenit 8 paragrafi 8.3 të Procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë theksohet: *“Konstatimet e parregullsisë funksionale të njehsorit elektrik siç përcaktohet në nenin 3 paragrafi i) të konstatuara në laboratorin e kalibrimit nuk mund të përdoren si provë e vetme meritore për ngarkimin e konsumatorit me faturën e rikthimit të energjisë së humbur”*.

Bordi i ZRRE-së ka konstatuar se duke i pasur parasysh rrethanat se ku ka qenë i vendosur njehsori elektrik ka qenë përgjegjësi e vet punëtorëve të autorizuar të KEK-ut, për sigurimin e këtij njehsori pasi që i njëjti ka qenë në ambient të hapur dhe i vendosur në shtyllën telefonike të I. edhe pse kjo shtyllë sipas pohimeve të konsumatorit ka qenë brenda rrethojës, andaj KEK, ka qenë i obliguar që të sigurojë më mirë këtë njehsor në mënyrë që të mos mund të dëmtohet eventualisht nga ndonjë person.

Bordi i ZRRE-së, gjithashtu ka vërejtur se KEK, nuk ka bërë një lexim të saktë të kësaj pike matëse dhe më këtë rast nuk ka vepruar konform dispozitave të nenit 5 paragrafi 3 nën paragrafi 3.6 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji që përcakton se Operatori i sistemit duhet të sigurojë lexim të saktë dhe të rregullt të njehsorëve elektrik.

Bordi i ZRRE-së, konsideron se DMK, ka vepruar konform dispozitave ligjore, në rastin e aprovimit të ankesës së konsumatorit U.G. (I.T) me të cilën ka kërkuar nga KEK-u që të shkarkoj nga borxhi i ngarkuar në vlerë prej 1,156.06€, si pasojë e ngarkesës dhe faturimit me rikthim të humbjeve.



Bordi i ZRRE-së, ka vlerësuar se KEK, në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së, nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen saktë se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së, me nxjerrjen e këtij vendimit, gjithashtu kundërshtimet të theksuara në ankesë kanë shumë kundërthënie njëra me tjetrën, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 01.03.2013 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_865_09_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar